

TAKIMI I DYTË 2024 - KOMITETI SEKTORIAL I TEKNOLOGJISË SË INFORMACIONIT DHE KOMUNIKIMIT

Mbledhja e Komitetit Sektorial të Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit u mbajt më datë **03.07.2024**.

Mbledhja u hap me prezantimin e vendimeve të marra nga Komiteti Sektorial gjatë gjithë veprimtarisë së tij, për të kaluar më pas në prezantimin e ofertës ekzistuese të kualifikimeve profesionale afatgjata dhe afatshkurtra. Sekretariati Teknik sqaroi se, të gjitha kualifikimet profesionale afatgjata që ishin rishikuar gjatë viteve 2020 - 2021, duhet të rishikoheshin gjatë vitit të ardhshëm.

AKAFPK informoi anëtarët se, qeveria shqiptare kishte vendosur të niste në muajin shtator pilotimin e arsimit të formës së dyfishtë për gjashtë kualifikime, ndër të cilat përfshihej edhe kualifikimi **“Multimedia”**. Po kështu, u bë me dije se, nga muaji shtator shkollat do të kishin mundësi të ofronin kualifikimin **“Siguria kibernetike”**, një kualifikim pas të mesëm me kohëzgjatje dy vjeçare, i cili kishte qenë propozim i KS.

Në vijim mbledhja u fokusua në një nga propozimet e mëparshme për ofrimin e një kualifikimi pas të mesëm për **“IT support specialist”**. Anëtarët dakordësuan se ishte një kualifikim shumë i nevojshëm në tregun e punës.

Një nga anëtarët ngriti si diskutim, një vëmendje të shtuar gjatë kohëve të fundit për gjysmëpërçuesit. Sekretariati informoi se, në drejtimin **“Elektroteknikë”** ekzistonte një modul i integruar në kurrikul për gjysmëpërçuesit, por u vlerësua mundësia që kjo përmbajtje të zgjerohet ose të zhvillohet si një kualifikim më vete.

Anëtarët diskutuan gjithashtu për Inteligjencën Artificiale (IA) dhe dolën me propozimin që të integrohet në të gjitha kualifikimet që do të rishikoheshin.

Pjesa e fundit e mbledhjes u fokusua në diskutimin për kualifikimet afatshkurtra që ofroheshin nga Qendrat e Formimit Profesional Publik (QFPP). Sekretariati informoi se, nisur nga propozimet e anëtarëve në mbledhjet e mëparshme AKAFPK kishte përgatitur programet e kurseve të unifikuara **“Zhvillim front-end-i”** dhe **“Hedhje të dhënash (Data Entry)”**, të cilat kishin dalë si nevojë nga gjetjet e Studimit të Nevojave për Aftësi. Sekretariati informoi se, Programet e Kurseve të Unifikuara ishin gati për tu ofruar nga QFPP. Në vijim të diskutimeve për pasurimin e ofertës, anëtarët propozuan të ofroheshin si kurse afatshkurtra 3 ose 6-mujore, krahas front-end-it edhe back end edhe një kurs për **“Software-in”**.

Gjithashtu, anëtarët propozuan që kurset afatshkurtra të fokusoheshin te framework-et, të cilat ishin të domosdoshme për kompanitë, por që nuk zhvilloheshin në universitete. Kurset mund të ishin të dedikuara kryesisht për framework-e, ndër më të rëndësishmet prej të cilave u përmendën:

React, Java, Python, Angular Js dhe Scram. U propozua që fillimisht të nisej me më kryesorët dhe më pas të zgjerohej oferta edhe me framework-e të tjerë.

Sekretariati bëri me dije se, gjatë gjysmës së dytë të vitit 2024, AKAFPK do të fokusohet në përgatitjen e programeve të kurseve të unifikuara, me qëllim që ato të ishin gati për t'u ofruar në vitin pasardhës.

Vendime të marra nga mbledhja:

1. Të përgatitej kualifikimi profesional pas të mesëm për ***“IT support specialist”***.
2. IA të integrohej në të gjitha kurrikulat për çdo profil të TIK.
3. Të përgatiteshin kurse afatshkurtra 3 - 6 mujore të dedikuara për framework-e si: React, Java, Python, Angular Js dhe Scram.
4. Të përgatitej një kurs afatshkurtër për ***“Software-in”***.
5. Të vlerësohej mundësia e ofrimit të një kualifikimi profesional për gjysmëpërçuesit.